

32009L0109

Direktiva 2009/109/KE E Parlamentit European dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat e Këshillit 77/91/KEE, 78/855/KEE dhe 82/891/KEE dhe Direktivën 2005/56/KE, në lidhje me kërkesat për raportimin dhe dokumentimin në rastin e bashkimit dhe ndarjes së shoqërive tregtare

Gazeta Zyrtare L 259 , 02.10.2009 fq.0014 – 0021

Direktiva 2009/109/KE E Parlamentit European dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat e Këshillit 77/91/KEE, 78/855/KEE dhe 82/891/KEE dhe Direktivën 2005/56/KE, në lidhje me kërkesat për raportimin dhe dokumentimin në rastin e bashkimit dhe ndarjes së shoqërive tregtare

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European, në veçanti nenin 44, paragrafi 2, germa “g”, të këtij Traktati,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social European [1],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit [2],

Duke pasur parasysh se:

(1) Këshilli European ka rënë dakord, në mbledhjen e datës 8 dhe 9 mars 2007, që të zvogëlohet me 25% barra administrative mbi shoqëritë tregtare brenda vitit 2012, në mënyrë që të rritet aftësia konkurruese e shoqërive tregtare brenda Komunitetit.

(2) Legjislacioni për shoqëritë tregtare është identifikuar si një fushë e cila vendos mbi shoqëritë tregtare detyrime të shumta për dhënie të informacioneve, disa prej të cilave duket

se janë të vjetruara ose të tepërta. Për rrjedhojë, duhen shqyrtuar këto detyrime dhe, sipas rastit, duhet zvogëluar barra administrative e vendosur mbi shoqëritë tregtare brenda Komunitetit, gjer në minimumin e nevojshëm për të mbrojtur interesat e grupeve të tjera të interesit.

(3) Në mënyrë që të pasqyrohen ndryshimet në legjislacionin finlandez për shoqëritë tregtare duhet përshtatur fusha e veprimit e Direktivës së dytë të Këshillit 77/91/KEE, datë 13 dhjetor 1976, për koordinimin e masave mbrojtëse të cilat ua kërkojnë shoqërive tregtare Shtetet Anëtare, për mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe të tjerëve, në kuadër të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, në lidhje me themelimin e shoqërive aksionare dhe mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit, për vendosjen në një nivel të këtyre masave mbrojtëse [3] dhe i Direktivës së tretë të Këshillit 78/855/KEE, datë 9 tetor 1978, në bazë të nenit 54 paragrafi 3 germa “g” të Traktatit në lidhje me bashkimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara të tregtuara në publik [4].

(4) Faqet e internetit të shoqërive tregtare ose faqet e tjera në internet, ofrojnë, në disa raste, një alternativë publikimi nëpërmjet regjistrave tregtarë. Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje t’i caktojnë këto faqe të tjera në internet që mund t’i përdorin pa pagesë shoqëritë tregtare për këtë publikim, siç janë faqet në internet të shoqatave të biznesit apo të dhomave të tregtisë ose platforma qendrore elektronike e përmendur në Direktivën e parë të Këshillit 68/151/KEE, datë 9 mars 1968, për koordinimin e masave mbrojtëse të cilat ua kërkojnë Shtetet Anëtare shoqërive tregtare për mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe të tjerëve, sipas paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, me qëllim vendosjen në një nivel të barasvlershëm të masave mbrojtëse në të gjithë Komunitetin [5]. Aty ku është e mundur të përdoret faqet në internet të shoqërisë tregtare apo faqeve të tjera në internet për publikimin e projektkushteve të bashkimit dhe/ose ndarjes dhe e dokumenteve të tjera që duhen vendosur në dispozicion të aksionarëve dhe kreditorëve, duke përmbushur garancitë për sigurinë e faqes së internetit dhe vërtetësinë e dokumenteve.

(5) Kërkesat në lidhje me bërjen publike të projektit të bashkimit ndërkufitar, sipas Direktivës 2005/56/KE të Bashkimit Europian dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005, për bashkimin ndërkufitar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara [6] duhet të jenë të ngjashme me ato që zbatohen për bashkimet dhe ndarjet e brendshme sipas Direktivës 78/855/KEE dhe Direktivës së gjashtë të Këshillit 82/891/KEE, datë 17 dhjetor 1982, në bazë të nenit 54 pika 3 germa “g” të Traktatit, që ka të bëjë me ndarjen e shoqërive aksionare[7].

(6) Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të parashikojnë që kërkesat e plota për raportimin ose informimin në lidhje me bashkimin apo ndarjen e shoqërive tregtare, të parashikuara në nenin 9 dhe nenin 11 pika 1 germa “c” të Direktivës 78/855/KEE dhe nenin 7 dhe nenin 9

pika 1 germa “c” të Direktivës 82/891/KEE, të mos jenë të detyrueshme për zbatim nëse kështu bien dakord të gjithë aksionarët e shoqërive tregtare të përfshira në bashkimin ose ndarjen në fjalë.

(7) Asnjë modifikim i Direktivave 78/855/KEE dhe 82/891/KEE që lejon një marrëveshje të tillë të aksionarëve nuk duhet të cenojë sistemet e mbrojtjes së interesave të kreditorëve të shoqërive tregtare në fjalë, dhe as rregullat që synojnë garantimin e dhënies së informacioneve të nevojshme punëmarrësve të këtyre shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike, siç janë autoritetet tatimore, të cilat kanë në kontroll bashkimin ose ndarjen e shoqërive tregtare sipas legjislacionit ekzistues të Komunitetit.

(8) Nuk është nevoja të caktohen kërkesa për hartimin e një pasqyre kontabël kur emetuesi, titujt e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, publikon raporte financiare gjashtëmujore në përputhje me Direktivën 2004/109/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, për harmonizimin e kërkesave ligjore për transparencë në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve pranohen për tregtim në një treg të rregulluar [8].

(9) Raporti i ekspertit të pavarur, që parashikohet në Direktivën 77/91/KEE, shpesh nuk nevojitet, nëse duhet hartuar edhe një raport i ekspertit të pavarur në mbrojtje të interesave të aksionarëve dhe kreditorëve në kontekst të bashkimit a ndarjes. Për rrjedhojë, Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësinë që në raste të tilla t’i përjashtojnë shoqëritë tregtare nga kërkesat për raportimin sipas Direktivës 77/91/KEE apo të parashikojnë që të dy raportet të mund të hartohen nga i njëjti ekspert.

(10) Bashkimet ndërmjet shoqërive mëmë dhe shoqërive të kontrolluara prej tyre kanë një efekt ekonomik më të vogël tek aksionarët dhe kreditorët kur përqindja e aksioneve që ka shoqëria mëmë tek shoqëria e kontrolluar arrin 90 për qind ose më shumë të aksioneve dhe titujve të tjerë me të drejtë vote. Kjo vlen edhe për disa ndarje, sidomos kur shoqëritë tregtare ndahen në shoqëri tregtare të reja që janë në pronësi të aksionarëve në përpjesëtim me të drejtat e tyre në shoqërinë tregtare që ndahet. Në këto raste, për rrjedhojë duhen zvogëluar kërkesat për raportimin të parashikuara në Direktivat 78/855/KEE dhe 82/891/KEE.

(11) Duke qenë se objektivi i kësaj direktive, pra zvogëlimi i barrës administrative sidomos në lidhje me detyrimet për publikimin dhe dokumentimin që u vendosen shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, të tregtuara në publik brendapërbrenda Komunitetit, nuk mund të arrihet në mënyrë të mjaftueshme nga Shtetet Anëtare dhe, për rrjedhojë dhe për arsye të

shkallës dhe efektit të masës që propozohet, mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, Komuniteti mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit siç parashikohet në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në të njëjtin nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për ta arritur këtë objektiv.

(12) Për rrjedhojë duhen bërë ndryshimet dhe shtesat përkatëse në Direktivat 77/91/KEE, 78/855/KEE, 82/891/KEE dhe 2005/56/KE.

(13) Në përputhje me pikën 34 të marrëveshjes ndërinstitucionale për një bërje më të mirë të legjislacionit [9], nxiten Shtetet Anëtare të hartojnë për vete dhe në interes të Komunitetit, tabelat e tyre të cilat të ilustrojnë sa të mundën përputhshmërinë ndërmjet kësaj direktive dhe masave që e kthejnë atë në legjislacion të brendshëm dhe t'i bëjnë publike këto tabela,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Ndryshime në Direktivën 77/91/KEE

Përmes këtij neni në Direktivën 77/91/KEE bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 1 pika 1, nënpika e katërbëdhjetë zëvendësohet me nënpikën e mëposhtme:

- "— në Finlandë: julkinen osakeyhtiö/publikt aktiebolag";

2. Në nenin 10, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“5. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos e zbatojnë këtë nen në rastin e themelimit të shoqërive të reja tregtare nëpërmjet bashkimit ose ndarjes, nëse hartohet një raport i ekspertit të pavarur për projektin e bashkimit a ndarjes.

Shtetet Anëtare, kur vendosin ta zbatojnë këtë nen në rastet e përmendura në nënparagrafin e parë , mund të parashikojnë që raporti i përgatitur sipas këtij neni dhe raporti i ekspertit të pavarur për projektin e bashkimit a ndarjes të mund të hartohet nga i njëjti ekspert ose nga të njëjtët ekspertë.”;

3. Neni 27 pika 3 zëvendësohet si më poshtë:

“3. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos e zbatojnë paragrafin 2 në rastin e zmadhimit të kapitalit të nënshkruar që bëhet për efekt të një bashkimi, ndarjeje apo oferte publike për blerje a shkëmbim të aksioneve dhe për të paguar aksionarët e shoqërisë tregtare, e cila po përthithet a po ndahet apo e cila është objekt i ofertës publike për blerjen a shkëmbimin e aksioneve.

Megjithatë, në rastin e një bashkimi a ndarjeje, Shtetet Anëtare zbatojnë vetëm paragrafin e parë të kësaj pike nëse hartohet një raport i ekspertit të pavarur për projektin e bashkimit a ndarjes.

Kur Shtetet Anëtare vendosin të zbatojnë paragrafin 2 në rastin e bashkimit a të ndarjes, ato mund të parashikojnë që raporti i përgatitur sipas këtij neni dhe raporti i ekspertit të pavarur për projektin e bashkimit a ndarjes të mund të hartohet nga i njëjti ekspert ose nga të njëjtët ekspertë.”.

Neni 2

Ndryshime në Direktivën 78/855/KEE

Përmes këtij neni në Direktivën 78/855/KEE bëhen ndryshime e mëposhtme:

1. Në nenin 1 pika 1, nënpika e katërmbëdhjetë zëvendësohet me nënpikën e mëposhtme:

- "— Finlanda: julkinen osakeyhtiö/publikt aktiebolag";

2. Në nenin 6, shtohen paragrafët e mëposhtëm:

"Çdonjëra prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim janë të përjashtuara nga kërkesa për publikimin e parashikuar në nenin 3 të Direktivës 68/151/KEE nëse, për një periudhë të vazhdueshme që fillon të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme gjatë së cilës do të merret një vendim për projektin e bashkimit dhe që mbaron jo më parë se mbyllja e mbledhjes së lartpërmendur, shoqëria tregtare i vendos në dispozicion të publikut kundrejt asnjë pagese projektin e bashkimit në fjalë në hapësirën e vet në internet. Shtetet Anëtare nuk e kushtëzojnë këtë përjashtim me asnjë kërkesë a kufizim që nuk është i nevojshëm për të garantuar sigurinë e hapësirës në internet dhe vërtetësinë e dokumenteve dhe mund t'i vendosin kërkesa a kufizime të tilla vetëm për aq sa këto janë në raport me arritjen e këtyre objektivave.

Si përjashtim nga paragrafi i dytë, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që publikimi të bëhet nëpërmjet platformës qendrore elektronike të përmendur në nenin 3 pika 4 të Direktivës 68/151/KEE. Në mënyrë alternative, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që një publikim i tillë të bëhet në cilëndo faqe tjetër në internet të caktuar prej tyre për këtë qëllim. Kur Shtetet Anëtare shfrytëzojnë njërin prej këtyre mundësive, ato kujdesen që shoqërive tregtare të mos u kërkohej të paguajnë asnjë tarifë specifike për një publikim të tillë.

Kur përdoret një hapësirë në internet që nuk është platforma qendrore elektronike, në këtë të fundit publikohet, të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, një njoftim me adresën e adresën e hapësirës në internet të përmendur në fillim të kësaj fjalie. Ky njoftim përfshin datën e publikimit të projektin të bashkimit në hapësirën në internet dhe vihet në dispozicion të publikut kundrejt asnjë pagese. Shoqërive tregtare nuk u kërkohej të paguajnë asnjë tarifë specifike për një publikim të tillë.

Ndalimi që nuk lejon t'u kërkohej shoqërive tregtare të paguajnë një tarifë specifike për publikimin, i parashikuar në paragrafët e tretë dhe të katërt, nuk e prek mundësinë e Shteteve Anëtare për t'ua kaluar shoqërive tregtare kostot e lidhura me platformën qendrore elektronike.

Shtetet Anëtare mund t'i kërkojnë shoqërisë tregtare ta ruajë informacionin për një periudhë specifike pas mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, në faqen e vet në internet ose, kur ka, në platformën qendrore elektronike apo në ndonjë faqe tjetër në internet të caktuar për këtë qëllim nga Shteti Anëtar në fjalë. Shtetet Anëtare mund të vendosin se cilat janë pasojat e

ndërprerjes së përkohshme të mundësisë së shikimit të faqes në internet apo të platformës qendrore elektronike, e shkaktuar nga faktorë teknikë ose nga faktorë të tjerë.”;

3. Në nenin 8, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Për qëllimet e germës “b” të paragrafit të parë, zbatohet neni 11 paragrafët 2, 3 dhe 4.”;

4. Neni 9 zëvendësohet me nenin e mëposhtëm:

"Neni 9

1. Organet administrative ose drejtuese të secilës prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim, hartojnë me shkrim një raport të hollësishëm ku shpjegohen projektin e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të, e në veçanti raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta.

Në këtë raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta që janë hasur gjatë vlerësimit.

2. Organet administrative ose drejtuese të secilës prej shoqërive tregtare të përfshira e informojnë asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së tyre tregtare dhe organet administrative ose drejtuese të shoqërive të tjera tregtare të përfshira, në mënyrë që këto të fundit të mund të informojnë më pas asambletë e përgjithshme përkatëse, për çdo ndryshim thelbësor në aktivet dhe pasivet, të ndodhur pas datës së përgatitjes të projektit të bashkimit dhe përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme ku do të merret vendim për projektin e bashkimit.

3. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që raporti i përmendur në paragrafin 1 dhe/ose informacioni i përmendur në paragrafin 2 të mos kërkohet, nëse kanë vendosur kështu të gjithë aksionarët dhe zotëruesit e titujve të tjerë me të drejtë vote të secilës prej shoqërive tregtare të përfshira në bashkim.”

5. Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

(a) paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

(i) germet “c” dhe “d” zëvendësohen me germet e mëposhtme:

“(c) sipas rastit, një pasqyrë kontabël të hartuar jo më parë se dita e parë e muajit të tretë që i paraprin datës së projektit të bashkimit, nëse pasqyrat kontabël më të fundit janë për një vit financiar që është mbyllur më shumë se gjashtë muaj përpara kësaj date;

(d) sipas rastit, raportet e organeve administrative të shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim të parashikuara në nenin 9;”;

(ii) Shtohet nënparagrafi i mëposhtëm:

"Për qëllimet e germës “c” të nënparagrafit të parë, nuk kërkohet pasqyra kontabël nëse shoqëria tregtare publikon një raport financiar gjashtëmuajor në përputhje me nenin 5 të Direktivës 2004/109/KE dhe këtë raport e vendos në dispozicion të aksionarëve në përputhje me këtë paragraf. Gjithashtu, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që të mos kërkohet pasqyra kontabël, nëse kështu kanë vendosur të gjithë aksionarët dhe zotëruesit e titujve të tjerë me të drejtë vote të secilës prej shoqërive tregtare të përfshira në bashkim.”;

(b) në paragrafin 3, shtohet nënparagrafi i mëposhtëm:

“Kur aksionari ka dhënë pëlqimin që shoqëria tregtare të përdorë mjetet elektronike për përcjelljen e informacionit, këto kopje mund të vihen në dispozicion nëpërmjet postës elektronike.”;

(c) Shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"4. Shoqëria tregtare është e përjashtuar nga kërkesa për të vendosur në dispozicion në selinë e saj të regjistruar dokumentet e përmendura në paragrafin 1 nëse, për një periudhë të vazhdueshme që fillon të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme gjatë së cilës do të merret një vendim për projektin e bashkimit

dhe që mbaron jo më parë se mbyllja e mbledhjes së lartpërmendur, shoqëria tregtare i vendos ato në dispozicion në faqen e vet në internet. Shtetet Anëtare nuk e kushtëzojnë këtë përjashtim me asnjë kërkesë a kufizim që nuk është i nevojshëm për të garantuar sigurinë e faqes në internet dhe vërtetësinë e dokumenteve dhe mund t'i vendosin kërkesa a kufizime të tilla vetëm për atë sa këto janë përpjesëtimore me arritjen e këtyre objektivave.

Paragrafi 3 nuk zbatohet nëse faqja në internet u jep aksionarëve, gjatë gjithë periudhës së përmendur në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, mundësinë t'i shkarkojnë dhe shtypin të gjitha dokumentet e përmendura në paragrafin 1. Megjithatë, në këtë rast, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që shoqëria tregtare duhet t'i mbajë të gatshme në selinë e regjistruar këto dokumente në rast se duan t'i shohin aksionarët.

Shtetet Anëtare mund t'i kërkojnë shoqërisë tregtare ta ruajë informacionin për një periudhë specifike pas mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, në faqen e vet në internet. Shtetet Anëtare mund të konstatojnë se cilat janë pasojat e ndërprerjes së përkohshme të mundësisë së shikimit të faqes në internet, e shkaktuar nga faktorë teknikë a faktorë të tjerë.";

6. Neni 13 paragrafi 2 zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“2. Për këtë qëllim, ligjet e Shteteve Anëtare parashikojnë, të paktën, që këta kreditorë të kenë të drejtë të përfitojnë nga masa mbrojtëse adekuate kur një mbrojtje të tillë e bën të nevojshme gjendja financiare e shoqërive tregtare që bashkohen, dhe kur këta kreditorë nuk kanë përfituar ende nga masa të tilla mbrojtëse.

Shtetet Anëtare përcaktojnë kushtet për mbrojtjen e parashikuar në paragrafin1 dhe në nënparagrafin e parë të kësaj pike. Në çdo rast, Shtetet Anëtare u garantojnë kreditorëve mundësinë që t'i drejtohen autoritetit administrativ apo gjyqësor kompetent për të marrë masa mbrojtëse të duhura, me kusht që të vërtetojnë në mënyrë të besueshme se bashkimi komprometon kreditet e tyre dhe se shoqëria tregtare nuk ka marrë asnjë masë mbrojtëse të duhur për ta.

7. Në nenin 23, hiqet paragrafi 4;

8. Neni 24 ndryshon si më poshtë:

(a) fjalia e dytë zëvendësohet me fjalinë e mëposhtme:

"Operacione të tilla rregullohen me dispozitat e Kapitullit II.";

(b) shtohet fjalia e mëposhtme:

"Megjithatë, Shtetet Anëtare nuk i vendosin kërkesat e parashikuara në germat "b", "c" dhe "d" të pikës 2 të nenit 5, në nenet 9 dhe 10, në nenin 11 pika 1 germa "d" dhe "e", në nenin 19 pika 1 germa "b" dhe në nenet 20 dhe 21.";

9. Neni 25 ndryshon si më poshtë:

(a) fjalët hyrëse zëvendësohen me fjalët e mëposhtme:

"Shtetet Anëtare nuk e zbatojnë nenin 7 për operacionet e përmendura në nenin 24 nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:";

(b) në germën "b", hiqet fjalia e dytë;

(c) shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Për qëllimet e germës "b" të paragrafit të parë, zbatohet neni 11 pikat 2, 3 dhe 4.";

10. Neni 27 ndryshon si më poshtë:

(a) fjalët hyrëse zëvendësohen me fjalët e mëposhtme:

“Në rastet kur bashkimi me përthithje bëhet nga një shoqëri tregtare e cila zotëron 90 për qind ose më shumë, por jo të gjitha, të aksioneve dhe titujve të tjerë me të drejtë vote në asamblenë e shoqërisë tregtare ose shoqërive të përthithura tregtare, Shtetet Anëtare nuk kërkojnë që bashkimi të miratohet nga asambleja e shoqërisë tregtare përthithëse, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme.”;

(b) germa “b” zëvendësohet me germën “b” të mëposhtme:

"(b) të paktën një muaj përpara datës së përcaktuar në germën “a”, të gjithë aksionarët e shoqërisë tregtare përthithëse duhet të gëzojnë të drejtën për të parë në selinë e regjistruar të shoqërisë tregtare dokumentet e parashikuara në gjerat “a”, “b” dhe, sipas rastit, gjerat “c”, “d” dhe “e” të pikës 1 të nenit 11;”;

(c) shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Për qëllimet e gjerës "b" të paragrafit të parë, zbatohet neni 11 pikat 2, 3 dhe 4.”;

11. Neni 28 ndryshon si më poshtë:

(a) fjalët hyrëse zëvendësohen me fjalët e mëposhtme:

“Shtetet Anëtare nuk i vendosin kërkesat e parashikuara në nenet 9, 10 dhe 11 në rastin bashkimit të kryer sipas nenit 27, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme.”;

(b) në germën “c”, shtohen fjalët e mëposhtme:

“ose nga një autoritet administrativ të përcaktuar për këtë qëllim nga Shteti Anëtar.”;

(c) shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Shteti Anëtar nuk e zbaton paragrafin e parë nëse ligjet e tij i japin të drejtë shoqërisë tregtare përthithëse, pa një ofertë të mëparshme publike për marrje në kontroll, t’u kërkojë të gjithë zotëruesve të titujve të mbetur të shoqërisë ose shoqërive që do të përthithen t’ia shesin asaj me çmim të drejtë këta tituj përpara bashkimit.”.

Neni 3

Ndryshime në Direktivën 82/891/KEE

Përmes këtij neni në Direktivën 82/891/KEE bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 4, ndryshohen paragrafët e mëposhtëm:

"Çdonjëra prej shoqërive tregtare të përfshira në ndarje janë të përjashtuara nga kërkesa për publikimin e parashikuar në nenin 3 të Direktivës 68/151/KEE nëse, për një periudhë të vazhdueshme që fillon të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme gjatë së cilës do të merret një vendim për projektin e ndarjes dhe që mbaron jo më parë se mbyllja e mbledhjes së lartpërmendur, shoqëria tregtare i vendos në dispozicion të publikut kundrejt asnjë pagese projektin e bashkimit në fjalë në faqen e vet në internet. Shtetet Anëtare nuk e kushtëzojnë këtë përjashtim me asnjë kërkesë a kufizim që nuk është i nevojshëm për të garantuar sigurinë e faqes në internet dhe vërtetësinë e dokumenteve, dhe mund t’i vendosin kërkesa a kufizime të tilla vetëm për aq sa këto janë përpjesëtimore me arritjen e këtyre objektivave.

Si shmangie nga paragrafi i dytë, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që publikimi të bëhet nëpërmjet platformës qendrore elektronike të përmendur në nenin 3pika 4 të Direktivës 68/151/KEE. Në mënyrë alternative, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që një publikim i tillë të bëhet në cilëndo hapësirë tjetër në internet të caktuar prej tyre për këtë qëllim. Kur Shtetet Anëtare përdorin njërin prej këtyre mundësive, ato sigurojnë që shoqërive tregtare të mos u kërkohej të paguajnë asnjë tarifë specifike për një publikim të tillë.

Kur përdoret një faqe në internet që nuk është platforma qendrore elektronike, në këtë të fundit publikohet, të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së

përgjithshme, një njoftim me adresën e faqes së internetit, të përmendur në fillim të kësaj fjalie. Ky njoftim përfshin datën e publikimit të projektit të ndarjes në faqen e internetit dhe vihet në dispozicion të publikut kundrejt asnjë pagese. Shoqërive tregtare nuk u kërkohet të paguajnë asnjë tarifë specifike për një publikim të tillë.

Ndalimi që nuk lejon t'u kërkohet shoqërive tregtare të paguajnë një tarifë specifike për publikimin, i parashikuar në paragrafët e tretë dhe të katërt, nuk e prek mundësinë e Shteteve Anëtare për t'ua kaluar shoqërive tregtare kostot e lidhura me platformën qendrore elektronike.

Shtetet Anëtare mund t'i kërkojnë shoqërisë tregtare ta ruajë informacionin për një periudhë specifike pas mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, në faqen e vet në internet ose, kur ka, në platformën qendrore elektronike apo në ndonjë faqe tjetër në internet të caktuar për këtë qëllim nga Shteti Anëtar në fjalë. Shtetet Anëtare mund të konstatojnë se cilat janë pasojat e ndërprerjes së përkohshme të mundësisë së shikimit të faqes në internet apo të platformës qendrore elektronike, e shkaktuar nga faktorë teknikë ose faktorë të tjerë.";

2. Në nenin 6, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Për qëllimet e germës "b" të paragrafit të parë, zbatohet neni 9 pikat 2, 3 dhe 4.";

3. Në nenin 7 pika 2, nënparagrafi i dytë zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

"Sipas rastit, bën të ditur përgatitjen e raportit për kundërpaguesën që nuk bëhet në mjete monetare, të përmendur në nenin 27 pika 2 të Direktivës 77/91/KEE, për shoqëritë tregtare marrëse dhe regjistrin ku duhet depozituar raporti.";

4. Në nenin 8, hiqet paragrafi 3;

5. Neni 9 ndryshon si më poshtë:

(a) paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

(i) germat “c” dhe “d” zëvendësohen me germat e mëposhtme:

"(c) sipas rastit, një pasqyrë kontabël të hartuar jo më parë se dita e parë e muajit të tretë që i paraprin datës së projektit të ndarjes, nëse pasqyrat kontabël më të fundit janë për një vit financiar që është mbyllur më shumë se gjashtë muaj përpara kësaj date;

(d) sipas rastit, raportet e organeve administrative të shoqërive tregtare të përfshira në ndarje të parashikuara në nenin 7 pika 1;"

(ii) Shtohet nënparagrafi i mëposhtëm:

"Për qëllimet e germës "c" të nënparagrafit të parë, nuk kërkohet pasqyra kontabël nëse shoqëria tregtare publikon një raport financiar gjashtëmujor në përputhje me nenin 5 të Direktivës 2004/109/KE dhe këtë raport e vendos në dispozicion të aksionarëve në përputhje me këtë paragraf.";

(b) në paragrafin 3, shtohet nënparagrafi i mëposhtëm:

"Kur aksionari ka dhënë pëlqimin që shoqëria tregtare të përdorë mjetet elektronike për përcjelljen e informacionit, këto kopje mund të vihen në dispozicion nëpërmjet postës elektronike.";

(c) shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"4. Shoqëria tregtare është e përjashtuar nga kërkesa për të vendosur në dispozicion në selinë e saj të regjistruar dokumentet e përmendura në paragrafin 1 nëse, për një periudhë të vazhdueshme që fillon të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme gjatë së cilës do të merret një vendim për projektin e ndarjes dhe që mbaron jo më parë se mbyllja e mbledhjes së lartpërmendur, shoqëria tregtare i vendos ato në dispozicion në hapësirën e vet në internet. Për dhënien e këtij përjashtimi, Shtetet Anëtare vendosin vetëm kërkesa dhe kufizime që janë të nevojshme për të garantuar sigurinë e faqes

në internet dhe vërtetësinë e dokumenteve, dhe mund t'i vendosin kërkesa a kufizime të tilla vetëm për atë që këto janë përpjesëtimore me arritjen e këtyre objektivave.

Paragrafi 3 nuk zbatohet nëse faqja në internet u jep aksionarëve, gjatë gjithë periudhës së përmendur në nënparagrafin e parë të kësaj pike, mundësinë t'i shkarkojnë dhe shtypin të gjitha dokumentet e përmendura në paragrafin 1. Megjithatë, në këtë rast, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që shoqëria tregtare duhet t'i mbajë të gatshme në selinë e regjistruar këto dokumente në rast se duan t'i shohin aksionarët.

Shtetet Anëtare mund t'i kërkojnë shoqërisë tregtare ta ruajë informacionin për një periudhë specifike pas mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, në faqen e vet në internet. Shtetet Anëtare mund të konstatojnë se cilat janë pasojat e ndërprerjes së përkohshme të mundësisë së shikimit të hapësirës në internet, e shkaktuar nga faktorë teknikë a faktorë të tjerë.";

6. Neni 12 paragrafi 2 zëvendësohet si më poshtë:

"2. Për këtë qëllim, ligjet e Shteteve Anëtare parashikojnë, të paktën, që këta kreditorë të kenë të drejtë të përfitojnë nga masa mbrojtëse të duhura kur një mbrojtje të tillë e bën të nevojshme gjendja financiare e shoqërive tregtare që ndahen dhe ajo e shoqërisë tregtare ku do të kalojë detyrimi në përputhje me projektin e ndarjes dhe kur këta kreditorë nuk kanë përfituar ende nga masa të tilla mbrojtëse.

Shtetet Anëtare përcaktojnë kushtet për mbrojtjen e parashikuar në paragrafin 1 dhe në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi. Në çdo rast, Shtetet Anëtare sigurojnë që kreditorët të lejohen të paraqesin kërkesë përpara autoritetit të duhur administrativ a gjyqësor për marrjen e masave mbrojtëse, me kusht që të tregojnë në mënyrë të besueshme se ndarja në fjalë e vë në rrezik përmbushjen e të drejtave të tyre dhe se nga shoqëria nuk është marrë ende asnjë masë mbrojtëse e duhur.";

7. Neni 20 ndryshon si më poshtë:

(a) fjalët hyrëse zëvendësohen me fjalët e mëposhtme:

"Pa cenuar nenin 6, Shtetet Anëtare nuk kërkojnë që ndarja të miratohet nga asambleja e shoqërisë tregtare që ndahet, nëse shoqëritë marrëse zotërojnë së bashku të gjitha aksionet e shoqërisë së ndahet dhe të gjithë titujt e tjerë me të drejtë vote në asamblenë e shoqërisë që ndahet, dhe nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:";

(b) në germën "b", hiqet fjalia e dytë;

(c) germa "c" hiqet;

(d) shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Për qëllimet e germës "b" të paragrafit të parë, zbatohet neni 9 pikat 2, 3 dhe 4 dhe neni 10.";

8. Neni 22 ndryshon si më poshtë:

(a) paragrafi 4 hiqet;

(b) paragrafi 5 zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

"5. Shtetet Anëtare nuk i vendosin kërkesat e parashikuara në nenet 7 dhe 8 dhe në germat "c", "d" dhe "e" të pikës 1 të nenit 9, kur aksionet në secilën prej shoqërive të reja u shpërndahen aksionarëve të shoqërisë tregtare që ndahet, në përpjesëtim me të drejtat e tyre në kapitalin e kësaj shoqërie.".

Neni 4

Ndryshime në Direktivën 2005/56/KE

Përmes këtij neni në Direktivën 2005/56/KE bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 6 pika 1, shtohen paragrafët e mëposhtëm:

"Çdonjëra prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim janë të përjashtuara nga kërkesa për publikimin e parashikuar në nenin 3 të Direktivës 68/151/KEE nëse, për një periudhë të vazhdueshme që fillon të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme gjatë së cilës do të merret një vendim për projektin e përbashkëta të bashkimit dhe që mbaron jo më parë se mbyllja e mbledhjes së lartpërmendur, shoqëria tregtare i vendos në dispozicion të publikut kundrejt asnjë pagese projekt-kushtet e përbashkëta të bashkimit në fjalë në faqen e vet në internet. Shtetet Anëtare nuk e kushtëzojnë këtë përjashtim me asnjë kërkesë a kufizim që nuk është i nevojshëm për të garantuar sigurinë e hapësirës në internet dhe vërtetësinë e dokumenteve dhe mund t'i vendosin kërkesa a kufizime të tilla vetëm për atë sa këto janë përpjesëtimore me arritjen e këtyre objektivave.

Si përjashtim nga nënparagrafi i dytë, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që publikimi të bëhet nëpërmjet platformës qendrore elektronike të përmendur në nenin 3 pika 4 të Direktivës 68/151/KEE. Në mënyrë alternative, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që një publikim i tillë të bëhet në cilëndo faqe tjetër në internet të caktuar prej tyre për këtë qëllim. Kur Shtetet Anëtare shfrytëzojnë njërin prej këtyre mundësive, ato kujdesen që shoqërive tregtare të mos u kërkohej të paguajnë asnjë tarifë specifike për një publikim të tillë.

Kur përdoret një faqe në internet që nuk është platforma qendrore elektronike, në këtë të fundit publikohet, të paktën një muaj përpara ditës së vendosur për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, një njoftim me adresën e faqes në internet të përmendur në fillim të kësaj fjalie. Ky njoftim përfshin datën e publikimit të projekteve të përbashkëta të bashkimit në faqen e internetit dhe vihet në dispozicion të publikut kundrejt asnjë pagese. Shoqërive tregtare nuk u kërkohej të paguajnë asnjë tarifë specifike për një publikim të tillë.

Ndalimi që nuk lejon t'u kërkohej shoqërive tregtare të paguajnë një tarifë specifike për publikimin, i parashikuar në nënparagrafët e tretë dhe të katërt, nuk e prek mundësinë e Shteteve Anëtare për t'ua kaluar shoqërive tregtare kostot e lidhura me platformën qendrore elektronike.

Shtetet Anëtare mund t'i kërkojnë shoqërisë tregtare ta ruajë informacionin për një periudhë specifike pas mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, në faqen e vet në internet ose, kur ka, në platformën qendrore elektronike apo në ndonjë hapësirë tjetër në internet të caktuar për

këtë qëllim nga Shteti Anëtar në fjalë. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë pasojat se cilat janë pasojat e ndërprerjes së përkohshme të mundësisë së shikimit të faqes në internet apo të platformës qendrore elektronike, e shkaktuar nga faktorë teknikë a faktorë të tjerë.";

2. Neni 15 paragrafi 2 zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

2. Kur bashkimin ndërkufitar me përthithje e bën një shoqëri e cila zotëron 90% ose më shumë, por jo të gjitha, të aksioneve dhe titujve të tjerë me të drejtë vote në asamblenë e shoqërisë a shoqërive të përthithura, detyrimi për raportin e ekspertit të pavarur dhe për dokumentet e nevojshme për shqyrtim zbatohet vetëm për atë që e kërkon ligji i brendshëm që rregullon shoqërinë përthithëse tregtare ose shoqërinë e përthithur tregtare, në përputhje me Direktivën 78/855/KEE."

Neni 5

Shqyrtimi

Pesë vjet pas datës së parashikuar në nenin 6 pika 1, Komisioni shqyrton funksionimin e atyre dispozitave të Direktivave 77/91/KEE, 78/855/KEE, 82/891/KEE dhe 2005/56/KE që janë ndryshuar ose shtuar me këtë direktivë dhe, në veçanti, efektet që kanë pasur te zvogëlimi i barrës administrative mbi shoqëritë tregtare, parë nga përvoja e fituar gjatë zbatimit të tyre. Komisioni i paraqet Parlamentit European dhe Këshillit një raport, të shoqëruar, sipas nevojës, me propozime për shtesa dhe ndryshime të mëtejshme në këto direktiva.

Neni 6

Kthimi në legjislacion të brendshëm

1. Shtetet Anëtare miratojnë dhe zbatojnë dispozita ligjore, rregullatore administrative të nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore të kësaj direktive përpara datës 30 qershor 2011. Shtetet Anëtare informojnë në lidhje me këtë Komisionin.

Gjatë miratimit të këtyre masave, Shtetet Anëtare përfshijnë një citim të kësaj direktive brenda masave në fjalë ose gjatë publikimit të tyre zyrtar. Mënyrën se si duhet bërë ky citim e përcaktojnë Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit vendas që miratojnë në fushën e rregulluar nga kjo direktivë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi 20 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

Neni 8

Entitetet të cilave u drejtohet direktiva

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 16 shtator 2009.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

J. Buzek

Për Këshillin

Presidenti

C. Malmström

[1] Opinion i datës 25 shkurt 2009 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare).

[2] Opinion i Parlamentit Europian, datë 22 prill 2009 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendim i Këshillit, datë 27 korrik 2009.

[3] GZ L 26, 31.1.1977, fq. 1.

(4) GZ L 295, 20.10.1978, fq. 36.

[5] GZ L 65, 14.3.1968, fq. 8.

(6) GZ L 310, 25.11.2005, fq. 1.

[7] GZ L 378, 31.12.1982, fq. 47.

[8] GZ L 390, 31.12.2004, fq. 38.

[9] GZ C 321, 31.12.2003, fq. 1.

Administruar nga Zyra e Publikimeve